



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI

VENDIM

Nr. 90, datë 31.05.2019

PËR
MIRATIMIN E NDRYSHIMIT TË EMRIT TË BANKËS “OTP ALBANIA” NË
FORMATET E LICENCAVE TË LËSHUARA NGA AUTORITETI I MBIKËQYRJES
FINANCIARE

Në bazë dhe për zbatim të nenit 14, pika 4, të Ligjit nr. 9572, datë 03.07.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”, i ndryshuar, të nenit 199, pika 4 të Ligjit nr. 52, datë 22.05.2014 “Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit”, pikës 3 të nenit 12 të Rregullores nr.79, datë 31.08.2015 “Për miratimin/licencimin e personave për të ushtruar veprimtarinë e agjentit në sigurime si dhe rastet e mospranimit të regjistrimi të tij dhe refuzimit të licencës”, të nenit 18, pika a/2 të Rregullores nr. 165, datë 23.12.2008 “Për licencimin e shoqërive të brokerimit/këshillimit, brokerit dhe këshilltarit të investimeve”, të nenit 9 të Rregullores nr. 21, datë 26.03.2009 “Për kushtet e autorizimit të kujdestarit të letrave me vlerë të Qeverisë”, si dhe nenit 47 të Ligjit nr. 10 197, datë 10.12.2009 “Për fondet e pensionit vullnetar”, me propozim të Zyrrave të Licencimit, Departamenti i Mbikëqyrjes së Tregut të Sigurimeve dhe Departamenti i Mbikëqyrjes së Tregut të Kapitaleve dhe Fondeve, Bordi i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare,

V E N D O S I:

1. Miratimin e ndryshimit të emrit të “Bankës Societe General Albania” në “Banka OTP Albania”, si dhe pasqyrimin e këtij ndryshimi në të gjitha formatet e licencave të lëshuara nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare.
2. Ngarkohen Zyrrat e Licencimit, Departamenti i Mbikëqyrjes së Tregut të Sigurimeve dhe Departamenti i Mbikëqyrjes së Tregut të Kapitaleve dhe Fondeve, për njoftimin dhe ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR
Pajtim MELANI

DREJTOR I PËRGJITHSHËM EKZEKUTIV
Ervin KOÇI